



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 29 dhjetor 2025
Nr. ref.: AGJ 2931/25

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI120/25

Parashtrues

Mustafa Shefkiu

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së kohëzgjatjes së procedurave në lëndën
trashëgimore [T.nr.21/ 10] në Gjykatën Themelore në Gjakovë dhe
[Ac.nr.2699/2023] në Gjykatën e Apelit të Kosovës**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Nexhmi Rexhepi, kryetar
Safet Hoxha, zëvendëskryetar
Bajram Ljatifi, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Enver Peci, gjyqtar
Jeton Bytyqi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Mustafa Shefkiu (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesi i kërkesës), i përfaqësuar nga Teki Bokshi, avokat nga Gjakova.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e kohëzgjatjes së procedurave gjyqësore të zhvilluara përkritazi me lëndën trashëgimore [T. nr. 21/10] në Gjykatën Themelore në Gjakovë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore), dhe [Ac. nr. 2699/2023] në Gjykatën e Apelit të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së kohëzgjatjes së procedurave në lëndën [T. nr. 21/10] të zhvilluara në Gjykatën Themelore dhe në Gjykatën e Apelit, me pretendimin se kjo cenon të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, siç garantohet me nenin 31 [E Drejta e Gjykimit të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 12 maj 2025, parashtruesi i kërkesës, përmes postës elektronike, dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 23 maj 2025, parashtruesi i kërkesës u njoftua për regjistrim të kërkesës.
7. Më 29 maj 2025, Kryetari i Gjykatës, përmes Vendimit [nr. GJR. KI120/25], caktoi gjyqtarin Jeton Bytyqi gjyqtar raportues dhe Vendimit [nr. KSH. KI120/25] Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Nexhmi Rexhepi (kryesues), Safet Hoxha dhe Bajram Ljatifi (anëtarë).
8. Më 28 korrik 2025, parashtruesi i kërkesës dorëzoi dokumente shtesë, përfshirë disa dokumente që ishin dorëzuar tek gjykatat e rregullta.
9. Më 28 korrik 2025, një kopje e kërkesës iu dërgua Gjykatës së Apelit, me ç' rast të njëjtës iu kërkua që të dorëzojë në Gjykatë informatat e nevojshme lidhur me fazën procedurale të lëndës trashëgimore të parashtruesit të kërkesës.
10. Më 3 shtator 2025, Gjykata e Apelit njoftoi Gjykatën se lënda e parashtruesit të kërkesës ka shenjë [Ac.nr.2699/2023] dhe gjendet në trajtim tek gjyqtari referues.
11. Më 11 dhjetor 2025, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës. Të njëjtën ditë, Gjykata, njëzëri, vendosi që: (i) kërkesa është e pranueshme; (ii) të konstatojë se ka pasur shkelje të paragrafit 2 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, dhe paragrafit 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së, përkritazi me të drejtën për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm brenda një afati të arsyeshëm kohor; si dhe (iii) të urdhërojë Gjykatën e Apelit që jo më larg se 30 mars

2026, ta informojë Gjykatën Kushtetuese lidhur me masat e ndërmarra për zbatimin e këtij Aktgjykimi, në pajtim me paragrafin 5 të rregullit 60 të Rregullores së punës

Përmbledhje e fakteve

12. Nga shkresat e lëndës rezulton se babai i parashtruesit të kërkesës, i ndjeri A. Sh. kishte ndërruar jetë më 15 prill 1983 në Gjakovë.
13. Më 12 maj 1983, në Gjykatën komunale në Gjakovë ishte hapur procedura trashëgimore lidhur me të ndjerin A. Sh, i cili përveç parashtruesit të kërkesës, ishte trashëguar nga bashkëshortja dhe fëmijët tjerë nga dy martesat e tij.
14. Procedurat e para trashëgimore ishin zhvilluar nga 10 prilli 1984, me ç’ rast ishin dhënë disa deklarata trashëgimore, duke pasuar me ndërprerje deri më 26 tetor 2005, 17 janar 2006, 7 qershor 2006 dhe 30 qershor 2010, kur ishin paraqitur edhe disa deklarata të tjera trashëgimore. Sipas dosjes së lëndës, seancat tjera në Gjykatën Themelore ishin mbajtur më 18 maj 2022 dhe 18 nëntor 2022.
15. Nga shkresat e lëndës po ashtu rezulton se parashtruesi i kërkesës disa herë kishte dorëzuar dokumentacion në Gjykatën Themelore, si dhe parashtrësia për zgjidhje më të shpejtë të procedurës trashëgimore të titulluara “urgjencë”, përfshirë më 14 mars 2022, 29 mars 2022, 15 prill 2022 dhe 27 shtator 2022.
16. Më 18 nëntor 2022, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [T. nr. 21/10] vendosi që të deklarojë trashëgimtarët ligjor të radhës së parë të trashëgimlënësit A. Sh. parashtruesin e kërkesës, si dhe trashëgimtarët e tjerë.
17. Më 29 nëntor 2022, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit duke kërkuar që Aktvendimi i Gjykatës Themelore [T. nr. 21/10] i 18 nëntorit 2022, të ndryshohet dhe parashtruesi i kërkesës të shpallet trashëgimtar i vetëm i trashëgimlënësit A. Sh. Parashtruesi i kërkesës po ashtu ngriti para Gjykatës së Apelit edhe çështjen e shkeljes së të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm brenda një afati të arsyeshëm.
18. Parashtruesi i kërkesës nga 7 gushti 2023 deri më 22 tetor 2024, në Gjykatën e Apelit kishte dorëzuar parashtrësia me qëllim të zgjidhjes më të shpejtë të procedurës trashëgimore të titulluara “urgjencë”.
19. Aktualisht rasti i parashtruesit është në pritje për t’u vendosur nga Gjykata e Apelit.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

20. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se kohëzgjatja e procedurës trashëgimore [T. nr. 21/10] në Gjykatën Themelore dhe në Gjykatën e Apelit, cenon të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, siç garantohet me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.
21. Parashtruesi i kërkesës thekson se procedura trashëgimore ka filluar qysh nga viti 1983 kur ka vdekur babai i tij A. Sh., si dhe nuk ka përfunduar ende. Në këtë kontekst, parashtruesi i kërkesës pretendon se “Në Gjykatën Komunale në Gjakovë aktvdekja apo dëshmia e vdekjes ka arritë me dt. 12.05.1983. Ky është momenti kur është nisur - filluar procedura trashëgimore”. Ai pretendon se i ndjeri [A. Sh.] pas vetes ka lënë trashëgimtare bashkëshorten dhe fëmijët. Ai shton se “Seanca e parë trashëgimore

është mbajtur me dt. 10.04.1984. Pastaj nuk është vepruar duket deri me 30.06.2010. Seanca e radhës ka ndodhur me dt. 18 maj 2022 dhe tjetra me 18 nëntor 2022. Përfundimisht Aktvendimi i Gjykatës së shkallës së parë ka arritur me dt. 18 nëntor 2022. Prej nga del se prej ditës së inicimit të procedurës deri në dorëzimin e aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë kanë kaluar 39 vite.”

22. Parashtruesi i kërkesës pretendon se edhe në procedurë në Gjykatën e Apelit ka zvarritje të paarsyeshme dhe thekson se “Lënda ka arritur në Gjykatën e Apelit të Kosovës dhe atje ka marr nr. punues Ac.nr. 2699/23. Nga ana e z. Mustafa, parashtruesit të kësaj kërkesë janë paraqitur shumë urgjenca me shkrim, me postë elektronike, me telefon por çështja nuk i zgjidhet edhe pse sipas strategjisë së KGJK lëndët e ujetra kanë prioritet në vendosje. Me vonesë të veprimit në ndërkohë trashëgimtarët, disa prej tyre kanë vdekur dhe pastaj është dashur që të mblidhen provat, autorizimet dhe deklaratat trashëgimore të trashëgimtarëve, kështu që palëve u janë krijuar edhe shpenzime krejtësisht të pa nevojshme. Trashëgimia u është dëmtuar. z. Mustafa kërkon edhe kompensimin për dëmin jo material që i është shkaktuar, përkatësisht dëmin për dhembje shpirtërore në lartësi prej 10.000,00 eurosh.”
23. Parashtruesi i kërkesës thekson se është e vërtetë se ka pasur shumë trashëgimtarë, mirëpo kjo procedurë trashëgimore nuk është aq komplekse dhe nuk ka asnjë justifikim që e njëjta të mos zgjidhet për tash e 40 vite.
24. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata: (i) kërkesa të deklarohej e pranueshme; (ii) të konstatojë se ka pasur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së; dhe (iii) të urdhërojë Gjykatën e Apelit që të ndërmarrë masa në zbatim të aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, por jo më larg se 6 muaj në pajtim me rregullin 60 të Rregullores së punës.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

*“1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.”*

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6

(E drejta për një proces të rregullt)

“1.Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohej nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës

*private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.
[...].”*

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

25. Gjkata së pari shqyrton nëse parashtruesit e kërkesës i kanë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuar me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.

26. Gjkata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

*“1. Gjkata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.
[...]*

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

27. Gjkata më tej i referohet neneve 47 (Kërkesat individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47 (Kërkesa individuale)

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjkata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund të ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48 (Saktësimi i kërkesës)

Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.

Neni 49 (Afatet)

Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. [...]

28. Në lidhje me afatshmërinë e kërkesës, Gjkata rikujton se parashtruesi i kërkesës konteston te zgjatjen e procedurës në Gjykatën Themelore dhe Gjykatën e Apelit, për mosvendosje në kohë të lëndës trashëgimore [T. nr. 21/10], e cila ende nuk ka përfunduar pranë kësaj të fundit. Gjkata, duke pasur parasysh natyrën e pretendimit, gjegjësisht te zgjatjen e procedurës pranë kësaj instance gjyqësore, rikujton se në rrethana të tilla nuk kërkohet përmbushja e kriterit të përcaktuar me nenin 49 (Afatet)

të Ligjit, përkatësisht kriteri për dorëzimin e kërkesës brenda afatit kohor prej katër (4) muajve.

29. Përveç kritereve të përcaktuara në Ligj, Gjykata shqyrton tutje nëse parashtuesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në paragrafin (2) të rregullit 34 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

Rregulli 34
(Kriteret e pranueshmërisë)

“(1) Gjykata mund ta konsideroj një kërkesë të pranueshme, nëse:

(...)

(d) kërkesa qartëson saktësisht dhe në mënyrë adekuate paraqet faktet dhe pretendimet për shkelje të të drejtave apo dispozitave kushtetuese.

(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtuesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

30. Gjykata gjithashtu konstaton se kërkesa i plotëson kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me paragrafin 1 të rregullit 34 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës dhe se e njëjta nuk mund të shpallet e papranueshme mbi bazën e kushteve të përcaktuara nëpërmjet paragrafit 2 të rregullit 34 të Rregullores së punës. Për më tepër dhe në fund, Gjykata thekson se kërkesa nuk mund të shpallet e papranueshme mbi asnjë bazë tjetër. Prandaj, ajo duhet deklaruar e pranueshme dhe duhet të vlerësohen meritat e saj.

Meritat e kërkesës

31. Gjykata rikujton se i ndjeri A. Sh. kishte ndërruar jetë më 15 prill 1983 në Gjakovë. Më 12 maj 1983, në Gjykatën komunale në Gjakovë ishte hapur procedura trashëgimore. Trashëgimlënësi, përveç parashtuesit të kërkesës, ishte trashëguar nga bashkëshortja dhe fëmijët e A. Sh. nga dy martesat e tij, përfshirë parashtuesin e kërkesës. Seanca e parë trashëgimore ishte mbajtur më 10 prill 1984, duke pasuar me një ndërprerje rezulton se disa deklarata trashëgimore ishin dhënë nga viti 2005 e tutje. Ndërsa, seancat tjera ishin mbajtur më 18 maj 2022 dhe 18 nëntor 2022. Parashtuesi i kërkesës gjatë vitit 2022 kishte dorëzuar dokumentacion në Gjykatën Themelore si dhe parashtresa për zgjidhje më të shpejtë të procedurës trashëgimore të titulluara “urgjencë”. Më 18 nëntor 2022, Gjykata Themelore nxori aktvendim në çështjen trashëgimore [T.nr.21/10]. Më 29 nëntor 2022, parashtuesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit, duke pretenduar, ndër të tjera, zvarritje të paarsyeshme të procedurës trashëgimore. Në procedurë në Gjykatën e Apelit, lënda trashëgimore ka shifrën [Ac.nr.2699/23]. Parashtuesi i kërkesës nga 7 gushti 2023 deri më 22 tetor 2024, në Gjykatën e Apelit kishte dorëzuar parashtresa me qëllim të zgjidhjes më të shpejtë të procedurës trashëgimore të titulluara “urgjencë”. Më 12 maj 2025, parashtuesi i kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese.
32. Lidhur me këtë, parashtuesi i kërkesës pretendon se si rezultat i kohëzgjatjes së paarsyeshme të procedurës trashëgimore në lëndën [T.nr.21/10], atij i është shkelur e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm brenda një afati të arsyeshëm, siç garantohej me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.
33. Andaj, Gjykata në vazhdim do të trajtojë këtë pretendim të parashtuesit të kërkesës në bazë të parimeve të përgjithshme të përcaktuara përmes praktikës së saj gjyqësore, por edhe asaj të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i

Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

Parimet e përgjithshme përkitazi me të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm brenda një afati të arsyeshëm

34. Gjykata fillimisht rikujton se paragrafi 2 i nenit 31 të Kushtetutës, përcakton: “Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme [...]”.
35. Ndërsa, paragrafi 1 i nenit 6 të KEDNJ-së përcakton se “Çdo person ka të drejtë që [...] të dëgjohet [...] brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë [...], e cila do të vendosë [...] në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij [...] civile [...]”.
36. Bazuar në dispozitat e lartcekura, e drejta për një vendim brenda një afati të arsyeshëm është pjesë përbërëse e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.
37. Lidhur me këtë, Gjykata tashmë ka një praktikë relativisht të konsoliduar gjyqësore që përfshinë, por nuk kufizohet në rastet (i) [KI64/23](#), parashtruese *Mejrem Qehaja Rexha*, Aktgjykim i 31 gushtit 2023; (ii) [KI06/21](#), parashtrues *Dragan Mihajlović*, Aktgjykim i 22 dhjetorit 2022; (iii) [KI19/21](#), parashtrues *Sadik Pllana*, Aktgjykim i 18 korrikut 2022; (iv) [KI177/19](#), parashtrues *NNT “Sokoli”*, Aktgjykim i 29 marsit 2021; dhe (vi) [KI142/23](#) parashtrues “*Fadil Berisha*”, Aktgjykim i 12 shkurtit 2025. Në praktikën e saj gjyqësore, Gjykata ka afirmuar parimet e vendosura nga GJENDJ, përfshirë rastet (i) [Erkner dhe Hofauer kundër Austrisë](#), nr. 9616/81, Aktgjykim i 23 prillit 1987; (ii) [Poiss kundër Austrisë](#), nr. 9816/82, Aktgjykim i 23 prillit 1987; (iii) [Abdoella kundër Holandës](#), nr. 12728/87, Aktgjykim i 25 nëntorit 1992; (iv) [Comingersoll S.A. kundër Portugalisë](#), nr. 35382/97, Aktgjykim i 6 prillit 2000; (v) [Mikulić kundër Kroacisë](#), nr. 53176/99, Aktgjykim i 7 shkurtit 2002; (vi) [Scordino kundër Italisë](#) (nr.1), [DhM] nr. 36813, Aktgjykim i 29 marsit 2006; (vii) [Frydlender kundër Francës](#), nr. 30979/96, Aktgjykim i 27 qershorit 2000; (viii) [Sürmeli kundër Gjermanisë](#), nr. 75529/01, Aktgjykim i 8 qershorit 2006; (ix) [Famullia Katolike Greke Lupeni dhe të tjerët kundër Rumanisë](#), nr. 76943/11, Aktgjykim i 29 nëntorit 2006; (x) [Mishqioni kundër Shqipërisë](#), nr. 18381/05, Aktgjykim i 7 dhjetorit 2010; dhe (xi) [Nicolae Virgiliu Tănase kundër Rumanisë](#), nr. 41720/13, Aktgjykim i 25 qershorit 2019.
38. Bazuar në praktikën e lartcekur gjyqësore, rezulton se (i) përlllogaritja e kohëzgjatjes së procedurave gjyqësore fillon nga momenti kur gjykata kompetente vihet në lëvizje me kërkesë të palës për vendosjen e një të drejte apo interesi legjitim të pretenduar; (ii) gjatë llogaritjes merret për bazë procedura në tërësinë e saj, përfshirë këtu edhe procedurat e apelimit dhe procedurën e ekzekutimit të një vendimi gjyqësor përfundimtar; (iii) arsyeshmëria e zgjatjes së një procesi gjyqësor duhet të vlerësohet duke u bazuar në rrethanat përkatëse dhe veçoritë e secilit rast; dhe se (iv) shteti është i detyruar që të organizojë sistemin e drejtësisë në mënyrë të tillë që gjykatat të mund të garantojnë të drejtat e secilit për një vendim përfundimtar gjyqësor, në lidhje me të drejtat dhe obligimet civile të tyre brenda një afati të arsyeshëm kohor (shih, rastet e GJEDNJ-së, [Poiss kundër Austrisë](#), cituar më lart, paragrafi 50; [Comingersoll kundër Portugalisë](#), cituar më lart, paragrafi 24; dhe [Lupeni Greek Catholic Parish dhe të tjerët kundër Rumanisë](#), cituar më lart, paragrafi 142; dhe rastet e Gjykatës [KI06/21](#), cituar më lart, paragrafët 50-75; dhe [KI19/21](#), cituar më lart, paragrafi 82; dhe [KI142/23](#), cituar më lart, paragrafi 47).

39. Për më tepër, sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës dhe asaj të GJEDNJ-së, arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedurës gjyqësore matet duke u bazuar në këto kritere kryesore: (i) kompleksiteti i rastit, (ii) sjellja e palës, (iii) sjellja e autoriteteve shtetërore, dhe (iv) rëndësia e asaj se çfarë është në rrezik për palën në kontestin gjyqësor (shih, rastin e GJEDNJ-së, [Surmeli kundër Gjermanisë](#), cituar më lart, paragrafi 128; si dhe rastet e Gjykatës KI64/23, cituar më lart, paragrafi 65; dhe [KI142/23](#), cituar më lart, paragrafi 48).
40. Përkitazi me (i) kompleksitetin e rastit, kjo mund të ndërlidhet me çështjet faktike dhe ligjore; me përfshirjen e disa palëve në procedurë; me një numër të caktuar provash që duhet trajtuar para gjykatave të rregullta; apo edhe me një numër më të madh të raporteve të ekspertëve që kërkohen. Thënë këtë, edhe në rastet kur një procedurë nuk është komplekse, mungesa e qartësisë dhe parashikueshmërisë në legjislacionin vendor, mund të vështirësojë zgjidhjen e rastit dhe të kontribuojë në kohëzgjatjen e procedurës (shih, në mënyrë të ngjashme rastet e Gjykatës [KI64/23](#), cituar më lart, paragrafët 66-67 [KI142/23](#), cituar më lart, paragrafi 49; dhe rastet e GJEDNJ-së, [Papachelas kundër Greqisë](#), nr. 31423/96, Aktgjykim i 25 marsit 1999; dhe [Nicolae Virgiliu Tanase kundër Rumanisë](#), cituar më lart, paragrafi 210).
41. Përkitazi me (ii) sjelljen e palës në procedurë, nuk kërkohet nga pala bashkëpunim aktiv me autoritetet gjyqësore, e as nuk mund të fajësohet pala për përdorimin e mjeteve juridike sipas legjislacionit në fuqi, megjithatë, autoritetet shtetërore nuk mund të mbahen përgjegjëse nëse këto veprime ndikojnë në kohëzgjatjen e procedurës; nga pala kërkohet vetëm të jetë e vëmendshme në ndërmarrjen e hapave proceduralë, dhe të mos përdorë taktika për ta shtyrë procedurën në favor të tij; dhe se, vetëm vonesat që i atribuohen Shtetit mund të ndikojnë në përcaktimin nëse procedurat nuk kishin përfunduar brenda një afati të arsyeshëm kohor. Disa shembuj që kanë të bëjnë me sjelljen e palës janë: mungesa e vullnetit për të dorëzuar shkresat, e cila mund të ndikojë në ngadalësimin e procedurës; ndryshimi i shpeshtë i avokatit; përpjekjet për të arritur marrëveshje jashtëgjyqësore; nisja e procedurës përpara gjykatës që nuk ka juridiksion për çështjen; mungesa e kujdesit në ndërmarrjen e hapave proceduralë (shih, rastet e GJEDNJ-së, [Erkner dhe Hofauer kundër Austrisë](#), cituar më lart, paragrafi 68; dhe [Union Alemntaria Sanders S.A kundër Spanjës](#), nr. 11681/85, Aktgjykim i 7 korrikut 1989, paragrafi 35). Sjellja e palës përbën një fakt objektiv që nuk mund t'i atribuohet autoriteteve shtetërore, dhe duhet të merret parasysh gjatë vlerësimit nëse procedura ishte kryer brenda një periudhe të arsyeshme kohore (shih, rastin e Gjykatës KI64/23, cituar më lart, paragrafi 68-70; dhe [KI142/23](#), cituar më lart, paragrafi 50).
42. Sa i përket (iii) sjelljes së autoriteteve kompetente, shteti mban përgjegjësi për të gjitha autoritetet dhe jo vetëm për sistemin gjyqësor, por edhe sjelljet e institucioneve publike; gjatë vlerësimit nëse procedura është kryer brenda një afati të arsyeshëm kohor; gjykata duhet ta vlerësojë procedurën në tërësi; përkundër që shteti mund të jetë përgjegjës për defekte të caktuara procedurale, megjithatë, kjo nuk e përjashton mundësinë që të ketë vepruar në përputhje me detyrat e veta për ta shqyrtuar rastin në mënyrë të shpejtë; shkaktimi i vonesave nga ndërrimi i shpeshtë i gjyqtarëve nuk e shmangë përgjegjësinë e shtetit për kryerjen e procedurave brenda afateve të arsyeshme kohore; mbingarkesa kronike e lëndëve nuk mund të shërbejë si arsyetim për tejzgjatjen e procedurave; dhe se gjykatat nuk mund të lejojnë që rasti të bartet pafundësisht prej një instance gjyqësore te tjetra (shih, rastet e Gjykatës KI64/23, cituar më lart, paragrafët 71-73; [KI06/21](#), cituar më lart, paragrafi 67; dhe [KI142/23](#), cituar më lart, paragrafi 51).
43. Sa i përket (iv) rëndësisë së e asaj se çfarë është në rrezik për palën në kontest, ekzistojnë kategori të caktuara të rasteve, të cilat, për nga natyra e tyre duhet të trajtohen me kujdes të veçantë dhe të vendosen me shpejtësi më të madhe. Shembuj të këtyre kategorive të rasteve përfshijnë: rastet që ndërlidhen me statusin; rastet që ndërlidhen

me kujdestarinë e fëmijëve; me raportin prind-fëmijë; me kujdesin e gjyshërve ndaj fëmijëve, kur këta të fundit kanë mbetur pa kujdesin e prindërve; përgjegjësinë e prindërve dhe të drejtat e kontaktit me fëmijët; rastet që ndërlidhen me kontestet nga marrëdhënia e punës; ankesa kundër largimit nga puna; suspendimi nga puna; transferimi; rikthimi në punë; rastet që ndërlidhen me persona të cilët vuajnë nga “*sëmundje të pashërueshme*” dhe kanë “*prirje të reduktuar të jetëgjatësisë*”; rastet që lidhen me pretendimet për ushtrim të dhunës nga zyrtarët policorë; dhe rastet kur mund të rrezikohet e drejta e edukimit. Disa raste të tjera nuk kërkojnë vëmendje të shtuar, për shembull, rastet që lidhen me kompensimin e dëmit të shkaktuar në aksidente rrugore, apo rastet që kanë të bëjnë me ndarjen e trashëgimisë ndërmjet trashëgimtarëve të personit të vdekur (shih, rastet e Gjykatës KI64/23, cituar më lart, paragrafi 74; [Kl06/21](#), cituar më lart, paragrafi 67; dhe [Kl142/23](#), cituar më lart, paragrafi 52).

Aplikimi i parimeve të lartcekura në rrethanat e rastit konkret

Periudha që do të merret parasysht

44. Gjykata rikujton se më 12 maj 1983, në Gjykatën Komunale në Gjakovë, pas vdekjes së babait të parashtruesit të kërkesës A. Sh., ishte hapur procedura trashëgimore. Seanca e parë trashëgimore ishte mbajtur më 10 prill 1984 duke pasuar me një ndërprerje deri në vitin 2005 e tutje kur ishin dhënë disa deklarata trashëgimore. Seancat tjera ishin mbajtur më 18 maj 2022 dhe 18 nëntor 2022. Më 18 nëntor 2022, Gjykata Themelore nxori aktvendimin në çështjen trashëgimore [T. nr. 21/10], me ç’ rast parashtruesit të kërkesës dhe disa personave të tjerë iu njoh e drejta e trashëgimitarit të babait të tij të ndjerë. Mirëpo, parashtruesi i kërkesës e kontestoi vendimin në fjalë në Gjykatën e Apelit, me ç’ rast kjo e fundit ende kishte në trajtim rastin në fjalë deri më 12 maj 2025, kur parashtruesi kishte parashtruar rastin në Gjykatë.
45. Prandaj, në rrethanat e rastit konkret, Gjykata vlerëson se rasti i parashtruesit të kërkesës ishte filluar në vitin 1983, ka vazhduar me disa deklarata trashëgimore nga viti 2005 dhe ka vazhduar të shqyrtohet edhe pas 15 qershorit 2008, kur Kushtetuta ka hyrë në fuqi. Gjykata Themelore ka nxjerrë vendim më 18 nëntor 2022 derisa procedura trashëgimore aktualisht është duke u shqyrtuar në Gjykatën e Apelit, sipas ankesës së parashtruesit të kërkesës dhe nuk është zgjidhur ende. Rrjedhimisht, periudha që do të merret parasysht nga Gjykata përfshin periudhën mbi shtatëmbëdhjetë (17) vite.
46. Gjykata, për të ardhur në përfundim nëse në rastin e parashtruesit të kërkesës, rasti i tij ishte trajtuar brenda afatit të arsyeshëm, në vijim do të vlerësojë (i) kompleksitetin e rastit, (ii) sjelljen e palës, (iii) sjelljen e autoriteteve shtetërore, si dhe (iv) rëndësinë e asaj se çfarë është në rrezik për palën në kontestin gjyqësor.

(i) Përkitazi me ndërlikueshmërinë e rastit

47. Për sa i përket ndërlikueshmërisë së çështjes, Gjykata bazuar në shkresat e lëndës vëren se në rastin konkret ka pasur shumë trashëgimtarë, të cilët në faza të ndryshme kanë dhënë deklarata të cilat kanë mundur të ndikojnë në vonesën e gjykatës së shkallës së parë për zgjidhjen e lëndës trashëgimore [T. nr. 21/10]. Megjithatë, Gjykata vlerëson se pavarësisht numrit të madh të trashëgimtarëve, procedura trashëgimore nuk është çështje posaçërisht e ndërlikuar.
48. Për më tepër, Gjykata vëren se gjykata e shkallës së parë nuk kishte nxjerrë aktvendim trashëgimor deri më 18 nëntor 2022. Kompleksiteti i lëndës trashëgimore nuk mund të justifikojë mosvendosjen e rastit deri në nëntor të vitit 2022, nga Gjykata Themelore. Aq më tepër, kompleksiteti i kësaj lënde trashëgimore nuk mund të justifikoj

mosvendosjen e së njëjtës edhe sot e kësaj dite nga Gjykata e Apelit, pra deri më 12 maj 2025, kur parashtruesi ka parashtruar kërkesën e tij në Gjykatë.

(ii) Përkitazi me sjelljen e palës

49. Lidhur me sjelljen e palëve, Gjykata përsëritë se më 12 maj 1983, në Gjykatën Komunale në Gjakovë, pas vdekjes së babait të parashtruesit të kërkesës, ishte hapur procedura trashëgimore. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës në disa raste përfshirë vitin 2022 kishte dorëzuar dokumentacion në Gjykatën Themelore si dhe parashtrësia për zgjidhje më të shpejtë të procedurës trashëgimore. Parashtruesi i kërkesës edhe në procedurë sipas ankesës në Gjykatën e Apelit nga 7 gushti 2023 deri më 22 tetor 2024, kishte dorëzuar parashtrësia me qëllim të zgjidhjes më të shpejtë të çështjes trashëgimore. Në këtë kontekst, Gjykata, duke pasur parasysh veprimet e ndërmarra nga parashtruesi i kërkesës, vlerëson se parashtruesi i kërkesës duke qenë palë në procedurë nuk i ka kontribuar vonesave por ishte i vëmendshëm në ndërmarrjen e hapave proceduralë, dhe se i njëjti nuk kishte përdorur mënyra për të shtyrë procedurën.

(iii) Sjellja e autoriteteve kompetente

50. Gjykata, në vlerësimin e sjelljes së autoriteteve kompetente, përkatësisht të gjykatës së shkallës së parë, thekson se procedura trashëgimore ka filluar më 10 prill 1984 dhe nuk është finalizuar deri në vitin 2022. Pas një periudhe të gjatë janë mbajtur seanca shqyrtuese me ç' rast, ndër të tjera, ishte konstatuar se gabimisht në dëshmitë e vdekjes janë shënuar emrat e disa prej trashëgimtarëve. Po ashtu gjatë periudhës 2005, 2006 deri më 20 dhjetor 2010, disa nga trashëgimtarët kishin deklaruar në Gjykatën Themelore se heqin dorë nga trashëgimia në dobi të parashtruesit të kërkesës. Pas një periudhe të gjatë, më 18 maj 2022, Gjykata Themelore kishte konstatuar, ndër të tjera, se njëri nga trashëgimtarët heq dorë nga trashëgimia në dobi të parashtruesit të kërkesës, ndërsa këtij të fundit iu kërkuar që në afat prej dhjetë ditësh të dorëzojë certifikatën e vdekjes së njëres prej trashëgimtarëve si dhe certifikatat e lindjes të njëres prej fëmijëve të saj. Procesverbali [T. nr. 43/84] ishte përpiluar nga Gjykata Themelore pas dorëzimit të parashtrësës nga parashtruesi i kërkesës më 19 prill 2022. Përfundimisht, Gjykata Themelore më 19 nëntor 2022 nxori aktvendim për lëndën trashëgimore të parashtruesit të kërkesës.
51. Duke pasur parasysh të lartcekurat, si dhe veprimet procedurale të ndërmarra nga gjykata e shkallës së parë, Gjykata thekson se përgjegjësia për zvarritjen e lëndës nuk mund t'i atribuohet, në këtë rast, sjelljes së parashtruesit të kërkesës por Gjykatës Themelore, e cila pa ndonjë arsye konkrete nuk kishte arritur të nxjerrë aktvendim për këtë lëndë trashëgimore deri më 18 nëntor 2022. Është e vërtetë se kjo lëndë trashëgimore ka të përfshirë shumë trashëgimtarë mirëpo kjo nuk do të thotë se është çështje posaçërisht e ndërlikuar. Gjykata vëren se shumë prej trashëgimtarëve janë deklaruar se heqin dorë nga trashëgimia në dobi të parashtruesit të kërkesës çka pa dyshim e thjeshton punën e Gjykatës Themelore. Gjykata po ashtu vëren se disa nga pengesat procedurale kanë mundur të paraqiten edhe për shkak të mosnjohjes së procedurës trashëgimore nga ana e trashëgimtarëve, por Gjykata Themelore ka për obligim ligjor që t'i udhëzojë palët për shfrytëzimin e drejtë të të drejtave procedurale të parashikuara me ligj. Gjykata vlerëson se Gjykata Themelore me nxjerrjen e vonuar të Aktvendimit të 18 nëntorit 2022, ka kontribuar në zgjatjen e paarsyeshme të procedurës trashëgimore. Periudha e zgjatur në mënyrë të paarsyeshme fillon së paku kur palët kanë dorëzuar deklaratat trashëgimore, çka nënkupton se procedura trashëgimore është zvarritur derisa nuk është nxjerrë aktvendimi i Gjykatës Themelore i 18 nëntorit 2022.

52. Gjykata rikujton se lënda trashëgimore është në procedurë në Gjykatën e Apelit që nga paraqitja e ankesës së parashtruesit të kërkesës më 29 nëntor 2022. Gjykata vëren se Gjykata e Apelit është përgjigjur se lëndën trashëgimore të parashtruesit të kërkesës është duke e trajtuar me prioritet. Në këto rrethana, Gjykata vlerëson se edhe në Gjykatën e Apelit tashmë kanë kaluar më shumë se tri (3) vite pa zgjidhje përfundimtare të lëndës trashëgimore. Edhe në këtë rast, Gjykata vlerëson se edhe Gjykata e Apelit ka kontribuar dhe vazhdon të kontribuojë në zvarritjen e paarsyeshme të lëndës trashëgimore të parashtruesit të kërkesës.

(iv) rëndësinë e asaj se çfarë është në rrezik për palën në kontestin gjyqësor

53. Lidhur me këtë, Gjykata ka sqaruar kategoritë e caktuara të rasteve, të cilat, për nga natyra e tyre duhet të trajtohen me kujdes të veçantë dhe të vendosen me shpejtësi më të madhe. Çështja e parashtruesit të kërkesës, jo domosdoshmërisht hyn në atë kategori.
54. Megjithatë, Gjykata thekson se nuk mund të konsiderohet e arsyeshme një periudhë kaq e gjatë për zgjidhjen e një rasti të tillë pranë Gjykatës Themelore, pavarësisht natyrës së rastit. Gjykata konsideron se tejzgjatja e trajtimit të çështjes në fjalë, është e papranueshme në rrethanat e rastit konkret dhe si e tillë është në kundërshtim të plotë me të drejtën e parashtruesit të kërkesës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm brenda një afati të arsyeshëm, ashtu siç garantohet nga paragrafi 2 i nenit 31 të Kushtetutës dhe paragrafi 1 i nenit 6 të KEDNJ-së.
55. Si përfundim, Gjykata marrë parasysh aplikimin kumulativ të kriterëve të lartcekura, konstaton se (i) megjithëse rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me procedurë trashëgimore, nuk rezulton të jetë i një natyre aq të ndërlikuar sa që do të mund të justifikonte që procedura gjyqësore për zgjidhjen e lëndës përkatëse të mos përfundojë as pas kaq shumë kohe; (ii) parashtruesi i kërkesës nuk ka kontribuar në tejzgjatjen e procedurës përmes veprimeve të tij, por vetëm ka ndjekur hapat procedural për realizimin e të drejtës së tij për të trashëguar pasurinë e trashëgimlënësit; ndërsa (iii) Gjykatës Themelore i janë dashur më shumë se pesëmbëdhjetë 15 vite që të nxjerrë një aktvendim trashëgimor, (iv) lënda trashëgimore e parashtruesit të kërkesës gjendet në procedurë në Gjykatën e Apelit, çka nënkupton se rasti i parashtruesit të kërkesës nuk është zgjidhur as pas më shumë se tetëmbëdhjetë (18) viteve.
56. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se në rrethanat e parashtruesit të kërkesës, Gjykata Themelore dhe Gjykata e Apelit kanë shkelur të drejtën e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm brenda një afati të arsyeshëm, siç garantohet me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.
57. Në këtë kontekst, Gjykata thekson se, pas këtij aktgjykimi nëpërmjet të cilit konstatohet shkelja e nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, gjykatat e rregullta duhet të ndërmarrin të gjitha hapat e nevojshëm për ta përmbyllur çështjen juridike të parashtruesit të kërkesës me prioritet, dinamikë të shtuar dhe brenda një afati sa më të shpejtë kohor, konform gjetjeve të këtij aktgjykimi.

Përkritazi me kërkesën për kompensim

58. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës ka kërkuar edhe që Republika e Kosovës t'ia kompensojë shumën prej 10,000.00 (dhjetëmijë) euro “në emër të dhimbjeve shpirtërore”.

59. Lidhur me këtë, Gjykata përsërit se nuk ka autorizime ligjore për caktimin e ndonjë lloji të kompensimit për rastet në të cilat konstaton shkelje të Kushtetutës dhe KEDNJ-së si pasojë e tejzgjatjes së procedurave gjyqësore (shih, rastet [KI19/21](#), parashtrues *Sadik Pllana*, cituar më lart, paragrafi 115; [KI06/21](#), cituar më lart, paragrafi 84; dhe [KI142/23](#), cituar më lart, paragrafi 68).
60. Gjykata përsërit se, në disa raste, gjetja e shkeljes kushtetuese paraqet një lloj të “shpërblimit të drejtë”, sidomos kur parashtruesi ka mundur të pësojë një dëm jo material. Megjithatë, individët mund të kërkojnë dëmshpërblim nga autoritetet publike në rast të konstatimit të shkeljes së të drejtave dhe lirive të tyre kushtetuese. Në rastet kur vetëm konstatimi i shkeljes nuk mjafton dhe kompensimi monetar është i domosdoshëm, individët kanë të drejtë të përdorin mjetet juridike në dispozicion për realizimin e të drejtave të tyre, përfshirë kompensimin e dëmit material dhe jomaterial pranë gjykatave të rregullta (shih, rastet e Gjykatës [KI113/21](#), parashtruese *Bukurije Haxhimurati*, Aktgjykim i 20 dhjetorit 2021, paragrafët 145-151; dhe [KI142/23](#), cituar më lart, paragrafi 69).

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës, në nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe rregullin 48 (1) (a) të Rregullores së punës, në seancën e saj të mbajtur më 11 dhjetor 2025, njëzëri:

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të pranueshme;
- II. TË KONSTATOJË se ka pasur shkelje të paragrafit 2 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe paragrafit 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, përkitazi me të drejtën për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm brenda një afati të arsyeshëm kohor;
- III. TË URDHËROJË Gjykatën e Apelit që jo më larg se 30 mars 2026, ta informojë Gjykatën Kushtetuese lidhur me masat e ndërmarra për zbatimin e këtij Aktgjykimi, në pajtim me paragrafin 5 të rregullit 60 të Rregullores së punës;
- IV. T’UA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve dhe, në pajtim me paragrafin 4 të nenit 20 të Ligjit, ta publikojë në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës;
- V. TË KONSTATOJË që ky Aktgjykim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

Gjyqtari raportues

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Jeton Bytyqi

Nexhmi Rexhepi